



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

01 Nr. 16-10142/15
Kaçanik, 01.04.2015

Në bazë të nenit 12.2(c) dhe 40.2(a) të Ligjit Nr. 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë: 01.04.2015, aprovoj këtë:

RREGULLORE
NDRYSHIM PLOTËSIMIN E E RREGULLORES 01 Nr.16-1846/13 PËR NDARJEN E
BURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Neni 1

Me këtë Rregullore, ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja 01Nr. 16-1846/13 për ndarjen e bursave të studentëve të komunës së Kaçanikut e datës, 31.01.2013, si vijon;

Neni 2

1. Në nenin 2 të rregullores të ndryshohen paragrafët 2.1 dhe 2.2 në këtë formë;
 - 1.1. Paragrafi 2.1 zëvendsohet me fjalën; lartësia e kompenzimit rregullohet me një vendim të veçant nga Kuvendi i Komunës.
 - 1.1.1. Paragrafi 2.2 zëvendsohet me fjalën; numri i bursave rregullohet me një vendim të veçant nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

1. Në nenin 9 të rregullores ndryshohet paragrafi 9.2 (a), ndërsa paragrafi 9.2 (d) hiqet.
 - 1.1.Paragrafi 9.2(b), pasuesi 10 pikë zëvendësohet me pasuesin, 15 pikë, ndërsa paragrafi 9.2(e), shëndrrohet në paragraf, 9.2(d).

Neni 4

1. Në nenin 15 të kësaj rregullore, ndryshohet paragrafi 15.1 dhe 15.3, ndërsa paragrafi 15.2, hiqet.

1.1.Paragrafi 15.2, zëvendësohet me fjalën: Studentëve përfitues të bursave do të iu lëshohet vendim i nënshkruar nga përfaqësuesi i DAK-së.

1.1.1. Paragrafi 15.3, zëvendësohet me fjalinë; me vendim do të përcaktohet kohëzgjatja e bursës, obligimet e përfituesit të bursës dhe kushtet tjera dhe i njëjti shëndrrohet në paragraf 15.2.

Neni 4

1. Në nenin 16 të kësaj rregullore të ndryshohet paragrafi 16.1.

1.1.Paragrafi 16. 1, zëvendësohet me fjalinë: Studentët që përfitojnë bursë, të njëjtën do ta marrin për një vit akademik, me mundësi vazhdimi në vitin vijues, nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e konkursit.

Neni 6

Rregullorja 01 Nr. 16-10142/15 për Ndryshim Plotësimin e Rregullores 01 Nr.16-1846/13 për Ndarjen e Bursave për Studentët e Komunës së Kaçaniku, pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e protokolit të MAPL-së si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të komunës së Kaçanikut.

Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelil Gashi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-KUVENDI I KOMUNËS-

01. Nr. 16-1846 /2013
Kaçanik, 31.01.2013

Në bazë të nenit 12.2 (c) dhe 40.2(e) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 34.5 Statutit të Komunës, të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 16-31150/12 për ndarjen e bursave të studentëve të komunës së Kaçanikut për vitin 2012/2013, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31.01.2013, aprovoj këtë:

Rregullore për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Kaçanikut

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet për aplikim, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës, lartësia e bursës, procedurat e përzgjedhjes së përfituesve të bursave dhe e drejta e ankesës.

Neni 2

- 2.1. Lartësia e bursës për një muaj është 50 € për një student.
- 2.2. Numri i bursave të ndarë është për 40 studentë.
- 2.3. Bursat ndahen për periudhën kohore 1 Tetor deri më 31 Korrik të vitit vijues akademik (10 Muaj).

Neni 3

Të gjithë studentët banorë të Komunës së Kaçanikut, të cilët janë studentë të rregullt në Universitet Publike, në studimet themelore, kanë të drejtë të konkurrojnë për përfitim të bursës.

II. Sigurimi dhe shfrytëzimi i mjeteve

Neni 4

Mjetet për bursa të studentëve sigurohen nga buxheti i Komunës së Kaçanikut.

Neni 5

- 5.1. Kuvendi i Komunës në bazë të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës, për çdo vit cakton numrin dhe shumën e bursës dhe cakton drejtimet me prioritet.
- 5.2. Bursat jepen prej vitit të dytë të studimeve.

Neni 6

- 6.1. Një student nuk ka të drejtë të marrë dy apo më shumë bursa nga njësitë buxhetore apo burime të ndryshme.
- 6.2. Nëse vërtetohet se studenti që është përfitues i bursës nga komuna, është duke marrë bursë edhe nga ndonjë njësi tjetër buxhetore ai/ajo obligohet ta kthejë bursën e komunës.

Neni 7

- 7.1. Prej një familje mund të merr bursë vetëm një student.
- 7.2. Nga studentët që i takojnë të njëjtës familje që plotësojnë kushtet për përfitimin e bursës, do ta përfitoj bursën studenti që ka notën mesatare më të lartë.

III. Kushtet për aplikim

Neni 8

Të drejtën për të aplikuar për bursë e kanë të gjithë studentët të cilët:

- a. Janë banorë rezident të Komunës së Kaçanikut,
- b. Janë student të rregullt, por jo me vetëfinancim,
- c. Kanë të kryera të gjitha provimet e vitit paraprak,
- d. Të mos jenë përsëritës të vitit,
- e. E kanë notën mesatare 7.5 e më të lartë, përveç studentëve të profileve deficitare (Fakulteti i Mjekësisë-Drejtimi i Përgjithshëm, Fakulteti Teknik- Drejtimi Elektro, Arkitekturë dhe Ndërtimtari, FSHMN-Drejtimi Matematikë-profilu Arsimor dhe Drejtimi Fizikë-profilu arsimor).
- f. Të jetë student i ndonjërit nga Fakultetet të Universiteteve Publike.

IV. Kriteret për përzgjedhje

Neni 9

- 9.1. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë, duke shumëzuar notën mesatare me koeficientin 5.
- 9.2. Studentët të cilët i takojnë kategorive të veçanta, u shtohen pikët si në vijim:
- a. Fëmija i dëshmorit, invalidit dhe veteranit të luftës (përparësi kanë fëmijët e këtyre kategorive me gjendje të rëndë ekonomike), 15 pikë.
 - b. Fëmijët e martirëve të luftës, studentë me gjendje të rëndë sociale, fëmija që është në mbikëqyrje të nënës, student i aftësi të kufizuara, 10 pikë.
 - c. Fëmijët pa prind, 15 pikë.
 - d. Studenti që ka marrë diplomë, mirënjohje, certifikata kombëtare ose ndërkombëtare në ndonjë garë-konkurs në lëmin arsimorë, 5 pikë.
 - e. Familja e cila ka dy e më tepër studentë, 10 pikë.

V. Konkursi

Neni 10

- 10.1. Bursat ndahen në bazë të Konkursit Publik.
- 10.2. Drejtoria për Arsim dhe Kulturë bënë shpalljen e konkursit publik në tabelën e publikimeve pranë komunës së Kaçanikut, në Ueb-faqen zyrtare të Komunës dhe në njërin nga gazetatat e shtypit ditorë.
- 10.3. Konkursi duhet të përmbajë:
- a. Kushtet për konkurrim

- b. Shumën e bursës për një vit akademik
- c. Dokumentet e nevojshme për konkurrim
- d. Profilet prioritare
- e. Afati për aplikim është 15 ditë.

Neni 11

12.1. Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

- a. Çertifikata e provimeve të dhëna origjinal dhe kopja e indexit,
- b. Çertifikata e bashkësisë familjare,
- c. Dëshmia që është student njëri nga kategoritë e dala nga lufta, e fëmijëve martirë, me gjendje të rëndë sociale dhe person me aftësi të kufizuara,
- e. Çertifikaten e vendbanimit,
- d. Çertifikatat dhe mirënjohjet kombëtare dhe ndërkombëtare si student i dalluar.

Neni 12

11.1. Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Zyrën e pritjes të Komunës së Kaçanikut.

11.2. Zyrtari që bënë pranimin e aplikacioneve, duhet:

- a. Të kontrolloj dokumentet e aplikimit nëse janë apo jo të kompletuara,
- b. Të regjistroj dokumentet që janë të bashkangjitura aplikacionit,
- c. Të vërtetoj a është fotokopja e indexit identike me origjinalin.

VI. Detyrat e Komisionit

Neni 13

13.1. Të verifikoj afatshmërinë e aplikacioneve dhe kompletimin e tyre me dokumentet e kërkuara.

13.2. Të bëjë vlerësimin me pikë të aplikuësve sipas kriterëve të parapara në këtë rregullore dhe përpilon listën prioritare.

13.3. Të publikojë në afat prej 3 ditë pune Vendimin me emrat e përfituesve të bursës në tabelën e shpalljeve dhe në Ueb-faqen zyrtare të Komunës.

VII. Vlerësimi i kushteve dhe kriterëve

Neni 14

14.1. Pas skadimit të afatit të konkurrimit, komisioni do të bëjë vlerësimin e aplikacioneve.

14.2. Komisioni gjatë procedurës së vlerësimit të aplikacioneve do të veproj sipas Nenit 9.

14.3. Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

14.4. Komisioni gjatë përzgjedhjes së përfituesve, vendos në pajtueshmëri të plotë të të gjithë anëtarëve.

Neni 15

15.1. Me studentët përfitues të bursës do të lidhet kontrata, e cila do të nënshkruhet nga përfaqësuesi i DAK-së.

15.2. Nëse brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e njoftimit të kandidatit përfitues të bursës, nuk nënshkruhet kontrata nga ana e studentit, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga bursa.

15.3. Me kontratë do të përcaktohet kohëzgjatja për të cilën jepet bursa, obligimet e përfituesit të bursës dhe kushtet e tjera.

Neni 16

16.1. Studentët që përfitojnë të drejtën në bursë, të njëjtën do ta marrin për një vit akademik, me mundësi vazhdimi në vitin vijues, nëse i plotëson kriteret e konkursit.

16.2. Nëse përfituesi i bursës ndërron fakultetin, humbë të drejtën e shfrytëzimit të bursës.

VIII. Procedura e pagesës

Neni 17

17.1. Lartësia e bursës e përcaktuar në nenin 2, pika 2.1 do t'iu alokohet në dy periudha të caktuara gjatë vitit në xhirrollogarinë, pranë ndonjë banke komerciale, të cilën janë të obliguar që studentët ta hapin.

17.2. Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, do të kujdeset për alokimin e mjeteve me kohë.

IX. Procedura e ankesave

Neni 18

18.1. Kundër vendimit të komisionit mund të ushtrohet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimit për përfituesit e bursës, drejtuar komisionit për Ankesa dhe Parashtresa të Komunës së Kaçanikut.

18.2. Vendimi i komisionit të ankesave është përfundimtarë në procedurë administrative.

X. Dispozitat kalimtare

Neni 19

19.1. Kjo rregullore miratohet nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut sipas procedurave për miratimin e akteve normative.

19.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregullore bëhen sipas procedurave për miratimin e akteve normative.

19.3. Për zbatimin e kësaj rregullore, përgjegjës është Drejtoria për Arsim dhe Kulturë të komunës së Kaçanikut.

Hyrja në Fuqi

Neni 20

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut.

Kryesues i Kuvendit
Xhelal Gashi

